

Dr. Genci HYSKA

Që prej muajit Nëntor 2018 është Drejtor i Përgjithshëm i Spitalit Obstetrik - Gjenekologjik "Koço Gliozheni", Tiranë.

Ka lindur në 22 Nëntor 1971 në Gjirokastrë, ku ka kaluar fëmijërinë dhe ka përfunduar arsimin e mesëm. Studimet e larta i ka kryer gjatë periudhës 1990 - 1995 në Fakultetin e Mjeksisë pranë Universitetit të Tiranës, në përfundim të së cilave është diplomuar Mjek i Përgjithshëm. Ka vijuar përgjatë periudhës 1998 - 2002 specializimin pranë Qendrës Spitalore Universitare Tiranë "Nënë Tereza", në përfundim është specializuar si Mjek Reaminator - Anestezist.

Dr. Genci ka kryer trajnime të ndryshme në fushën e Menaxhimit dhe Planifikimit Shëndetësor, organizuar nga Universiteti i Montrealit në bashkëpunim me Fakultetin e Mjeksisë në Universitetin e Tiranës në vitin 2003; në fushën e Menaxhimit të Kujdesin Shëndetësor Spitalor, organizuar Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Universitetin Rush, Chicago, Illinois gjatë viteve 2007 - 2008, në fushën e anestezisë dhe reaminacionit organizuar nga Shërbimi i Anestezisë - Reaminacionit në Qendrën Spitalore Universitare Tiranë "Nënë Tereza".

Dr. Genci ka një përvojë dhe eksperiencë të gjatë pune si mjek dhe si drejtues në shërbimin shëndetësor. Duke filluar në vitin 1995 punën si Mjek i Përgjithshëm në Spitalin Rajonal "Omer Nishani" Gjirokastrë, më pas ka drejtuar Shërbimin Parësor Mjekësor në Drejtorinë e Shëndetit Publik Gjirokastrë. Në vitin 2002 ka punuar si mjek reaminator - anestezist në Reaminacionin e Shërbimit Onkologjik në Qendrën Spitalore Universitare Tiranë "Nënë Tereza", ndërsa në vitin 2004 ka vijuar punën si mjek reaminator - anestezist në Shërbimin e Reaminacionit të Spitalit Obstetrik - Gjenekologjik "Koço Gliozheni". Në vitin 2016 ka mbajtur postin e Zëvendës Drejtorit Mjekësor në Spitalin Obstetrik - Gjenekologjik "Koço Gliozheni", në të njëjtën kohë ka mbajtur postin e anëtarit të asamblesë rajonale të Urdhërit të Mjekut Tiranë për një periudhë 5 vjeçare.

Dr. Genci përveç punës si mjek ka një angazhim aktiv edhe në jetën akademike, ai është lektor në disa universitete si dhe autor dhe bashkëautor i dhjetra botimeve shkencore në fushën e anesteziës, reaminacionit, shëndetit publik etj. Gjithashtu ka një angazhim edhe në jetën publike të qytetit duke qënë anëtar i Këshillit Bashkiak në Bashkinë Tiranë si dhe anëtar i Këshillit të Qarkut Tiranë.

Info: Genci.Hyska@suogj-kglioazheni.gov.al